



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 10 / 2025

Dt: 13.01.2025

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nr 01-400/01-0051689/20 të datës 04.12.2020 e miratuar nga Kuvendi Komunal - Skenderaj, Drejtoria për Arsim, shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE

PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË SKENDERAJT

Komuna e Skenderajt ndanë **100 bursa** për studentët e kësaj komune, që studiojnë në universitetet publike të Kosovës në vitin akademik **2024-2025**, në të gjitha fakultetet apo drejtimet e studimit (megjithëse vetëm studentët e disa fakulteteve marrin pikë bonus, të gjithë studentët kanë mundësi të përfitojnë bursa). Vetëm studentët e rregullt të nivelit Bachelor kanë të drejtë konkurimi për përfitimin e bursës komunale.

Vlera e bursës komunale për një student është **500 euro**.

Për studentët, që janë në vitin e parë të studimeve do të ndahen **20 bursa**, ndërsa bursat tjera do të ndahen për studentët që janë në vitin e dytë, vitin e tretë dhe në vitin e katërt të studimeve.

Kushtet e konkurrimit për bursë komunale

Kandidati duhet:

1. Të jetë banor i Komunës së Skenderajt;
2. Të jetë student i rregullt në vitin akademik 2024-2025, në ndonjërin nga universitetet publike të Kosovës;
3. Të jetë student i nivelit Bachelor;
4. Të mos e ketë përsëritur (humbur) vitin akademik;
5. Të mos jetë në marrëdhënie pune me pagesë;
6. Të mos jetë përfitues i bursave tjera për vitin akademik shkollor 2024/25 (nga institucionet publike, private dhe të tjera) ;

Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të bursave komunale

Përfitues të bursës komunale nuk mund të jenë dy apo më shumë studentë nga e njëjta familje.

Përzgjedhja e përfituesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme. Nëse një kandidat i plotëson më shumë se një nga kriteret/kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati).

Studentët me pikë të barabarta në listën përfundimtare do të renditen sipas notave mesatare. Nëse notat mesatare janë të njëjta, atëherë do të merret për bazë renditja alfabetike.

Nr.	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Nota mesatare në studime 9.51 - 10.00	40
	Nota mesatare 09.01 – 9.50	30
	Nota mesatare 8.00 - 9.00	20
	Nota mesatare 7.01 - 8.00	10
	Nota mesatare 6.00 - 7.00	5
	Për studentët e vitit të parë pa nota – me dëftesën shkëlqyeshëm të klasëve 10-12	40
	Për studentët e vitit të parë pa nota – me dëftesën shumë mirë të klasëve 10-12	30
	Për studentët e vitit të parë pa nota – me dëftesën mirë të klasëve 10-12	20
2	Student/e nga familja me ndihmë sociale	10
3	Fëmijë me nevoja të veçanta	10
4	Student/e bonjak/e (pa të dy prindërit)	10
5	Student/e – fëmijë i dëshmorit të UÇK-së	10
6	Student/e – fëmijë i invalidit të luftës së UÇK-së	5
7	Student/e – fëmijë i veteranit të luftës së UÇK-së	5
8	Studente (gjinisë femërore)	5
9	Student, që studion më shumë se një drejtim studimi - mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Doktoratë) përveç studimeve Bachelor ose Master	5
10	Student që ka edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtari tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoratë)	5
11	Studentët e drejtimeve deficitare në Komunën e Skenderajt; Studentët e degëve të Mjekësisë Studentët e drejtimit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike Studentët e drejtimit e Shkencave Matematiko – Natyrore Studentët e drejtimit e Fizikës dhe Kimisë Studentët e drejtimit e Gjuhës Gjermane Studentët e drejtimit e Gjuhës Angleze Studentët e drejtimit e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	5

Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.

Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:

Të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formularin e aplikimit të plotësuar (merret në katin e parë, sporteli nr.13) ose

shkarkohet nga faqja e komunës;

- Dokumentin personal (letërnjoftimin ose pasaportën);
- Ekstraktin e lindjes ose Certifikatën e lindjes;
- Kartelën Identifikuese të studentit;
- Vërtetimin nga universiteti publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se, kandidati është student i rregullt në vitin përkatës të studimeve, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve, që kandidati e ka të regjistruar vitin akademik 2024 - 2025 dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik;
- Certifikatën e notave të studimeve;
- Studentët që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme (kopjet e dëftësave të shkollës së mesme).
- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) se, kandidati nuk ka marrëdhënie të rregullt pune.

Kandidatët që i plotësojnë kriteret e sipërpërkruara në tabelë duhet të dorëzojnë:

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 1 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe certifikatën e notave;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 2 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 3 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 4 - certifikatat e vdekjes së të dy prindërve;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 5 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 6 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 7 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe certifikatën familjare;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 9 - dëshminë zyrtare nga universiteti publik;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 10 - dëshminë zyrtare nga universiteti publik për anëtarin e familjes dhe certifikatën familjare.

Sqarime shtesë

Të gjitha dokumentet që dorëzohen me rastin e aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen për t'u konfirmuar të dhënat vetëm për kandidatët që përzgjidhen si përfitues të bursave.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi është i hapur prej datës **13.01.2025 deri më 27.01.2025**. Aplikacionet pranohen çdo ditë pune prej orës 09:00 - 15:00. Përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale dhe do të publikohen në webfaqe të komunës së Skenderajt.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë, në sportelin nr.13 përmes protokollit, në objektin e Komunës së Skenderajt.

Drejtoria e Arsimit

